



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Broshurë,
3-mujori i tretë,
2022

Përgjegjësia Sociale e Korporatave

Korrik - Shtator 2022




ALPHA BANK



“Zhvillimi i qëndrueshëm përfshin integrimin e balancuar të objektivave socialë dhe mjedisorë me objektivat e zhvillimit ekonomik” (Samiti Botëror në Johannesburg për Zhvillimin e Qëndrueshëm, 2002)

Këto tre aspekte të zhvillimit të qëndrueshëm - shoqëri, mjedis dhe ekonomi – janë riafirmuar në Samit si tri shtylla të ndërlidhura.

Në këtë kontekst iniciativat e ndërmarra nga bankat konsiderohen si një përpjekje në mbështetje të aktiviteteve ekonomike, të cilat stimulojnë investime. Por dhe synojnë të ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e standardit të jetesës dhe mirëqenien e një komuniteti, si dhe në mbrojtjen e mjedisit dhe ndërgjegjësimin ndaj ndryshimeve klimaterike.



SHOQËRIA

Qëllimet dhe treguesit socialë konsiderohen si një tjetër dimension kyç për matjen e zhvillimit, pasi ato fokusohen më shumë në rritjen dhe ruajtjen e produktivitetit të burimeve njerëzore përgjatë brezave. Kjo kërkon shfrytëzimin dhe mbështetjen e shërbimeve sociale bazë si shëndetësia dhe arsimi, së bashku me sigurimin e drejtësisë sociale në shpërndarjen e burimeve natyrore pa i varfëruar ato.



► Projekti pilot mbi studimin e ADHD-së “Çrregullimit të Pamjaftueshmërisë së Vëmendjes me Hiperaktivitet” tek fëmijët e moshës 7-10, mbështetet për herë të parë në Shqipëri nga **Banka Amerikane e Investimeve**. Ky projekt i ndërmarrë nga Medical Institute of Albania (MIA) do të shtrihet për një periudhë 18 mujore, me qëllim ndërgjegjësimin, parandalimin, identifikimin, diagnostikimin, trajtimin në kohë dhe rritjen e kapaciteteve të profesionistëve që menaxhojnë popullatën me ADHD.

- Banka mbështeti “*Land & Sand Art Festival*”, zhvilluar për herë të parë në Shqipëri, si një risi e artit në rërë. Artistë nga vende të ndryshme të Evropës u bënë bashkë për të ndërtuar në bregdetin e Velipojës skulpturat e tyre prej rëre.



Banka Kombëtare Tregtare edhe këtë vit ka përqafuar fushatën e mbledhjes së ndihmave për familjet dhe personat në nevojë, organizuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Tiranë. Fushata përkoi me Festën e Kurban

Bajramit, ku punonjësit e BKT në Tiranë dhe rrethe dhanë kontributin e tyre vullnetar. Vetëm pranë Kryqit të Kuq Tiranë punonjësit e bankës u gjendën pranë 85 familjeve në nevojë.




► Në mbështetje të fëmijëve në nevojë ka udhëtuar nëpër rrethe të Shqipërisë duke dhuruar çanta me mjete shkollore, të cilat ju dhuruan 34 fëmijëve në Sarandë, 20 fëmijëve në Shkodër, 20 fëmijëve në Korçë dhe 63 fëmijëve në Kavajë.

- Dhuroi 210 libra për Bibliotekën Publike Korçë-Bashkia Korçë.
- Mbështeti shkollën Gjimnazi Janaq Kilica - Zyra Vendore Arsimore Fier në ceremoninë e diplomimit të nxënësve.
- Kontribuoi në përmirësimin e kushteve dhe ambienteve të disa institucioneve duke i dhuruara materiale dhe mjete të tjera të nevojshme, si p.sh.: kondicionerë, pajisje kompjuterike etj.. Konkretisht u mbështetën: OSHKSH dhe Qendra Spitalore të Burgjeve (Instituti i Veçantë Shëndetësor i të Dënuarve); Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan; Spitali Psikiatrik Elbasan; Qendra Shëndetësore Selitë dhe ASHK Tirana Rurale 1.



- ▶ Në mbështetje të kulturës dhe artit Credins Bank ka sponsorizuar aktivitete që përcjellin mesazhe të rëndësishme për komunitetin si dhe promovojnë vlerat kulturore historike si dhe traditat shqiptare, si p.sh.: Finalen e konkursit "Tirana Art Fest"; shumë koncerte dhe festivale, veprimtarinë Digital Nomad Tirana; përkthimin e librit të ambasadorit të SHBA në Tiranë të vitit 1939 Hugh Grant, etj..



INTESA SANPAOLO BANK Albania

- ▶ Më datë 30 qershor u organizua konkursi "ECO-QUIZ" me pjesëmarrjen e 120 fëmijëve të moshës 13 - 16 vjeç në Qendrën TUMO. Fëmijët u ndanë në 10 grupe dhe duhej t'u përgjigjeshin pyetjeve rreth Sfidës Financiare dhe Mjedisore, bazuar në disa koncepte si menaxhimi i parave, qëndrueshmëria në mjedis dhe parimet e ekonomisë qarkulluese. Në 23 deri më 25 shtator, ekipit fitues prej 15 fëmijësh iu mundësua një udhëtim mësimor në Torino të Italisë, ku vizituan Muzeun e Kursimeve, një institucion i rëndësishëm i edukimit financiar dhe ambientet e Qendrës së Inovacionit të Intesa Sanpaolo, një qendër për promovimin e zhvillimeve teknologjike.
- ▶ Kryetari i Bordit të Drejtorëve të Grupit Intesa Sanpaolo, Prof. Gian Maria Gros-Pietr, gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri, më datë 6 korrik mbajti një leksion të hapur të ndjekur nga një publik prej më shumë se 200 personash, me temë "Investimi tek njerëzit mundëson një zhvillim të qëndrueshëm".
- ▶ Në datën 16 shtator 2022, u zhvillua gjatë pjesës së parë të ditës trajnimi "Banka në Lëvizje" për stafin e Intesa Sanpaolo Bank Albania. Temat e përzgjedhura ishin disa aspekte të bankës që mund të përmirësohen, ku mund të përmendim: digjitalizimin, motivimin e punonjësve, kënaqësinë e klientit, riskun dhe depërtimin e huadhënies. Pjesa tjetër e ditës u pasua nga "Festa Vjetore e Stafit", ku mori pjesë i gjithë stafi i Intesa Sanpaolo Bank Albania nga Zyrat Qendrore dhe të gjitha degët në Shqipëri.
- ▶ Nga data 23 deri në datën 25 shtator, Intesa Sanpaolo Bank Albania mori pjesë në Eventin Sportiv të organizuar nga Divizioni i Bankave Filiale Ndërkombëtare në Poreç, Kroaci. Rreth 800 pjesëmarrës garuan në kampionatet e futbollit, basketbollit dhe volejbollit duke krijuar një atmosferë pozitive gjatë gjithë veprimtarisë.



otpbank

- ▶ "Festa e Birrës" në Korçë festoi përvjetorin e 15-të. Banka OTP Albania, në përkrahje të traditës kulturore shqiptare, ka mbështetur këtë aktivitet.
- ▶ Përkujtimi i kryengritjes mbarë popullore matjane e 31 korrikut të vitit 1943 shoqërohet çdo vit me një sërë aktivitete në qytetin e Burrelit. Ky event kulturor kishte përkrahjen financiare të Bankës OTP Albania për realizimin e tij.




- ▶ Dhurimi i gjakut, një akt jetik për përfituesit e tij, por edhe shumë sublim për vetë dhuruesit, merr një tjetër dimension, kur i përgjigjemi thirrjes si një institucion i vetëm. Banka OTP Albania iu përgjigj thirrjes për dhurimin e gjakut nga një numër i konsiderueshëm punonjësish.
- ▶ Banka OTP Albania ka mbështetur organizimin e ceremonisë së diplomimit të maturantëve për ZVAP – Vlorë, Himarë dhe për Bashkinë Devoll. Veprimtaritë u zhvilluan respektivisht në qytetin e Vlorës dhe Bilishtit, pjesëmarrës të së cilit ishin maturantët dhe familjarët e tyre.
- ▶ Festivali Sunny Hill, mbërriti për herë të parë në Shqipëri, me mbështetjen e ProCredit Bank. U mirëpritën mijëra vizitorë në ProCredit Chill Zone, për lojëra mbi edukimin financiar dhe përdorimin e shërbimeve digjitale përmes lojërave interaktive dhe dhuratave.



**Raiffeisen
BANK**

Pjesë e Grupit RBI

- ▶ Gjatë muajit korrik, si pjesë e programit “RBAL Wellness”, u organizuan aktivitete me ekspertë rreth shëndetit fizik duke marre shkas nga problematikat e stinës së verës.
- ▶ Raiffeisen mbështeti akademinë e inovacionit në Korçë. Akademia hapi dyert më 18 korrik dhe veprimtaria e saj u shtri në tre etapa: kampi veror dy javor, instruksione nga instruktorë të Universitetit Stanford të SH.B.A. dhe në përmblyllje një projekt grupi.
- ▶ Më 28-30 korrik, për të tretin vit me radhë, Raiffeisen mbështeti edicionin e 6-të të Za-Fest si sponsor i përgjithshëm. Festivali promovoi gjithashtu turizmin në qytetin e Shkodrës.
- ▶ Raiffeisen mbështeti Check In Fest në qytetin e Gjirokastrës në datat 2-5 shtator. Festivali, përmbante muzikë dhe ekspozita, festat për fëmijë dhe konferenca shkencore, për të promovuar kulturën dhe trashëgiminë e qytetit.
- ▶ Raiffeisen mbështeti edicionin e nëntë të Festivalit Mbarëkombëtar të Komedisë, Koko Fest. Nga data 3 deri më 9 shtator, qyteti i Korçës mirëpriti këtë festë komedie me tetë shfaqje.
- ▶ Raiffeisen promovon sportin për një jetë të shëndetshme, ndaj dhe mbështeti aktivitetin sportiv, gjysmë maratonën e vrapimit “Wolf Trail Running”, më datë 11 shtator. Fundjava dedikuar kësaj gjysmë-maratone, ofroi aktivitete të ndryshme të shoqëruara me muzikë, si free Pasta Festival ditën pararendëse datë 10 Shtator, si dhe ditën e veprimtarisë.



MJEDISI

...e drejta për zhvillim duhet të përmbushë në mënyrë të njëtrajtshme nevojën për zhvillim dhe mjedis të brezave në të tashmen dhe në të ardhmen.

(Neni 3[8] i Deklaratës së Rio-s, si dhe paragrafi 11 i Deklaratës së Vjenës mbi të drejtat e njeriut.)



Nismës së Bashkisë Durrës "Dhuro një Pemë", i është bashkuar **Banka Kombëtare Tregtare**, nismë e cila shton hapësirat e gjelbra në qytet, nëpërmjet mbjelljes së pemëve të reja.

Duke dhuruar një pemë, mund të krijojmë një mjedis më të pastër si dhe të sigurojmë rritjen e cilësisë së jetës për çdo qytetar, vlerësuar kjo si një nga pasuritë më të mira që mund t'i lëmë brezave që vijnë.



Stafi i **Banka Kombëtare Tregtare, Credins Bank** dhe **OTP Bank Albania** iu bashkuan nismës *Bike to work Day*, një nga aktivitetet e organizuara në kuadër të Javës Evropiane të Lëvizshmërisë.

Le të përdorim sa më shumë biçikletën si mjet transporti në përditshmëri, për një mjedis më të pastër dhe për një mënyrë jetese më të shëndetshme!



Credins Bank mbështeti edicionin e tretë të *Vjosa River Volley*, në Përmet, ku përgjatë tre ditëve, u zhvilluan seminare për mbrojtjen e lumit të Vjosës, aksione komunitare në pastrim të plazheve publike përgjatë lumit si dhe ndeshjet finale të kupës së volejbollit 2022 në kategori amatore dhe profesioniste.





► Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me qëllim për të përmirësuar efikasitetin e energjisë në Shqipëri, uljen e ndikimeve negative në kushtet klimaterike dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së individit, ka ofruar një linjë kredie prej 3 milion euro për ProCredit Bank. Ky fond do të nxisë realizimin e investimeve në: izolimin e mureve ose çatisë, dritare apo dyer të reja, panele diellore, pompa ngrohje ose kaldaja me te pastra dhe efikase me synimin për të arritur kursimin e energjisë. Pas përfundimit të suksesshëm të investimeve, familjet kanë mundësinë të marrin grant stimulues me vlerë nga 15-20% të kredisë, financuar nga BE, duke e bërë me të përballueshëm investimin nga ana monetare.

- Në kuadër të iniciativave të vazhdueshme për mbrojtjen e mjedisit dhe jetesën e shëndetshme, ProCredit Bank ka dhuruar për stafin e saj çanta pambuku dhe gota qeramike me qëllim reduktimin e përdorimit të plastikës në institucion, si dhe 2,000 çanta pambuku, të cilat janë shpërndarë nëpërmjet supermarketeve. Produktet janë prodhuar me materiale të riciklueshme dhe mbi të gjitha e biodegradueshme ul ndikimet negative në mjedis.
- ProCredit Bank morri pjesë në Festivalin e parë të *Circular Design* në Shqipëri dhe kontribuoi në dhënien e njohurive lidhur me aspekte të ndryshme bankare dhe ekologjike për këtë projekt. Workshopi pati për qëllim ndërtimin e një platforme të ideuar dhe dizajnuar në baza ekologjike.



Pjesë e Grupit RBL

Raiffeisen mbështeti "Growing Hackathon", sfidë me fokus në kërkimin e zgjidhjeve të gjelbra e jo vetëm, që vjen në datat 12-13 shtator. Tre sfida, katër çmime dhe mentorë profesionistë që do të bëjnë të mundur një eksperiencë formuese dhe rritëse.



EKONOMIA

...Dimensioni ekonomik i qëndrueshmërisë ka të bëjë me ndikimet e organizatës në kushtet ekonomike të aktorëve të saj dhe në sistemet ekonomike në nivel lokal, kombëtar dhe global. Kategoria Ekonomike ilustron fluksin e kapitalit midis palëve të ndryshme të interesit dhe ndikimet kryesore ekonomike të organizatës në të gjithë shoqërinë.

(Global Reporting Initiative. GRI G4 pjesa 2:, faqe 67)



Nëpërmjet një partneriteti të ri të nënshkruar mes ABI Bank dhe UNDP Albania, banka financoi një shumë prej 100,000 USD për të mbështetur 50 biznese mikro dhe të vogla në rimëkëmbjen nga pasojat e tërmetit. Këto biznese do të mbështeten nëpërmjet metodologjisë In Motion, e cila është aplikuar me sukses nga UNDP në vendet e prekura nga fatkeqësitë natyrore, duke përfshirë edhe Shqipërinë. "In Motion" synon të stabilizojë kushtet ekonomike të bizneseve mikro dhe të vogla, të rivendosë dhe të përmirësojë veprimtaritë e tyre ekonomike në treg. UNDP gjithashtu do të ofrojë ndihmë teknike të personalizuar, duke nisur nga diagnoza deri në planet e përmirësimit të biznesit.



Credins Bank kontribuoi në mirëmbajtjen e lulishtes së Shtëpisë së Pushimit të Ministrisë së Brendshme, duke krijuar një ambient të shëndetshëm dhe relaksues për institucionin .



Një prej iniciativave nga **Fibank** është rikonstruksioni i një varke në pronësi të bashkisë Pustec. Kjo varkë përdoret në liqenin e Prespës, një vend shumë i bukur ku ka shumë hapësirë për zhvillimin e më tejshëm të turizmit.



► Banka i është bashkuar Programit Kombëtar të Praktikave të Punës. Ky program i mundësoi 9 të rinjve nga moshë 21-26 vjeç që kanë mbaruar studimet në nivelin bachelor



të aplikonin për mundësi praktike 3 mujore në departamente të ndryshme pranë Bankës.

- U vlerësua sërish si "Banka më e mirë dixhitale në Shqipëri për vitin 2022" nga revista ndërkombëtare prestigjioze Global Banking Finance.



ProCredit Bank

- Onboarding Programme është tashmë një praktikë e përvitshme e ProCredit Bank me qëllim trajnimin, zhvillimin personal dhe profesional si dhe punësimin e të rinjve të sapo diplomuar. Banka investon në realizimin e 8 programeve Onbording çdo vit, duke mirëpritur si pjesë të stafit kolegët e rinj. Të rinjtë kanë mundësinë të trajnohen në qendrën e trajnimeve në Beograd, së bashku me kolegët e tjerë të rinj të bankave rajonale ProCredit. Në përfundim të këtij programi secili nga të rinjtë pjesëmarrës ka mundësinë e punësimit.
- Në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Qeverinë Shqiptare me fokus zhvillimin e agrobiznesit ofron mundësi financimi me kushte preferenciale për prodhuesit, agro-përpunuesit dhe fermerët. Investimet në fokus janë: ndërtimi dhe rinovimi i ambienteve të biznesit, panele diellore, zgjerim kapacitetesh prodhuese dhe magazinuese. Përveç të gjithave kushteve lehtësuese në sigurimin e kredi marrjes, agrobiznesi që investon merr 10% të financimit në formë granti në fund të realizimit të investimit. Me qëllim për të qenë sa më afër nevojave dhe kërkesave të tyre banka ishte pjese e një seminari informues të organizuar nga BERZH e mbështetur nga BE dhe Qeveria Shqiptare. ProCredit Bank prezantoi edhe mënyrat e financimit me kushte preferenciale të përshtatura enkas për agrobiznesin.



TIRANA BANK

- Mbështetëse kryesore e Konkursit dhe Panairit Kombëtar të Kompanive të Nxënësve organizuar nga Junior Achievement Albania. Panairi konsiderohet si aktiviteti kulmor pas 9 muajve trajnime të vazhdueshme dhe ndjekje të moduleve me zgjedhje "Drejtues për një ditë" dhe "Kompania e nxënësve" që Junior Achievement Albania ka realizuar për klasat 10,11,12 të shkollave në rang vendi.
- Tirana Bank ka mbështur edhe këtë vit traditën si partner zyrtar i festivalit mbarëkombëtar të gjysheve, "Nona", që u mbajt në Përmet nga data 5 deri më 7 gusht.
- Konkursi "Sfida e Biznesit" organizuar nga Tirana Bank në partneritet me B4Students, iu bashkuan me propozimet e tyre studentët pjesëmarrës, 9 prej të cilëve u kualifikuan për fazën finale. Fituesve iu mundësua shpërblim monetar, trajnim profesional në platforma ndërkombëtare online si edhe pjesëmarrja në programin e praktikës profesionale dhe punësimit në shoqëritë e Grupit BALFIN. B4Students ka nisur regjistrimet në edicionin e tretë të Konkursit të Ideve të Biznesit, për studentët që kërkojnë të nisin një biznes dhe u nevojitet mbështetje financiare, trajnim praktik dhe mentorim nga ekspertë.

